



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P- 014

Prishtinë, më 22 dhjetor 2017, në orën 19:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Osman Shatri dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Kërkesa e 43 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se 43 deputetë kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit më 22 dhjetor 2017, me këtë:

Rend dite

1. Procedimi i Projektligjit për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e lartshënuar.

Lidhur me kërkesën e 43 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme lidhur me procedimin e Projektligjit për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 19:30, për të vazhduar në orën 21:00.

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, në orën 21:00

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit dhe Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, si dhe nga grupet parlamentare: Memli Krasniqi, Ahmet Isufi dhe Bilall Sherifi.

Kryetari i procedoi me vazhdimin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Lidhur me kërkesën e 43 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari, në mungesë të kuorumit për vendimmarrje lidhur me kërkesën e 43 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme, e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, në orën 21:20.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale